



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)**

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “4 S” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L64425401K**, me seli: *Fier, Lushnje, LUSHNJE, Lagjja “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Qerim Arapi”, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4.*

Procedura e prokurimit: “E Hapur - Mallra”, prokurim elektronik – Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj.

Numri i referencës së procedurës: REF-97263-03-04-2024

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Loti Nr. 2: “Blerje Fruta – Perime”, me fond limit për shumatoren e çmimeve për njësi në vlerën: **2 226** (dy mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) **lekë pa TVSH**. Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes kuadër: **1 542 866** (një milion e pesëqind e dyzet e dy mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**, ndarë për vitin 2024 në vlerën: 771 433 (shtatëqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH**, nga grandit: 521 433 (pesëqind e njëzet e një mijë e katërqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH**, dhe nga të ardhurat: 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) **lekë pa TVSH**, ndërsa për vitin 2025 në vlerën: 771 433 (shtatëqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH**, nga grandit: 521 433 (pesëqind e njëzet e një mijë e katërqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH**, dhe nga të ardhurat: 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) **lekë pa TVSH**, me afat realizimi të marrëveshjes kuadër: **24** (njëzet e katër) **muaj**.

Publikime të mëparshme: nuk ka patur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 14, datë 11 Mars 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: “4 S” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L64425401K.**

Vlera e ofruar për totalin (shumatoren) e çmimeve për njësi: **1 750** (një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Vlera e ofruar për sasinë e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes kuadër: **1 479 520** (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e njëzet) lekë pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik: “NELSA” Sh.p.k., me numër Nipt-i: J71601012S.

Vlera e ofruar për totalin (shumatoren) e çmimeve për njësi: **1 905** (një mijë e nëntëqind e pesë) lekë pa TVSH.

Vlera e ofruar për sasinë e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes kuadër: **1 525 120** (një milion e pesëqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e njëzet) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: “NELSA” Sh.p.k., me numër Nipt-i: J71601012S.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

- ❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “NELSA” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:**

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.3/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë në pronësi ose në përdorim sipas kontratës noteriale ambiente të përshtatshme për magazinimin e mallrave të kërkuara (me sipërfaqe totale jo më pak 50 m²) si dhe me ambient frigoriferik (me sipërfaqe të dhomës frigoriferike jo më pak se 5 m²) e pajisur me leje Higjeno-sanitare, çertifikatë e mbrojtjes nga zjarri, raport – analizën e ujit të rrjetit, çertifikatë DDD e vlefshme, dhe Foto të ambienteve e dhomës frigoriferike (të paktën 2), ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet: dokumentacioni i cituar dhe deklarata nga ana e operatorit ekonomik që ambienti ka sipërfaqet e kërkuara.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur konstatohet se:**

- **Për ambientet e marra në huapërdorje me kontratën noteriale me Nr.Rep.41, Nr.Kol.17, datë 11.01.2021: “Garazh” me nr. pasurie: 199/32-G1 dhe sip. 234 m², “Njësi” me nr.pasurie: 199/32-N1 dhe sip. 208 m², dhe “Njësi” me nr.pasurie: 199/32-N2, dhe sip. 103 m², nuk janë paraqitur çertifikatat e mbrojtjes nga zjarri, raport analizat e ujit të rrjetit, ndërsa çertifikata DDD është paraqitur vetëm për ambientin “Garazh” me nr. pasurie: 199/32-G1 dhe sip. 234 m².**

- Për ambientin e marr në huapërdorje me kontratën noteriale me Nr.Rep.315, Nr.Kol.124/1, datë 08.03.2022: “Garazh” me nr. pasurie: 199/32-G3 dhe sip. 96 m², nuk është i pajisur me *leje Higjeno-sanitare* (pasi Akt-Miratimi Higjeno-Sanitar Nr.1884 datë 11.12.2015 është paraqitur për ambientet e tjera (cituar më lart), si dhe *Çertifikata për sigurinë nga zjarri* është lëshuar për një ambient tjetër me sipërfaqe 280 m².

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: “4 S” Sh.p.k., me seli: *Fier, Lushnje, LUSHNJE, Lagjja “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Qerim Arapi”, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4*, me numër Nipt-i: **L64425401K**, se oferta e paraqitur për sasinë e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes kuadër: **1 479 520** (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e njëzet) **lekë pa TVSH**, dhe me vlerë të ofruar për totalin (shumatoren) e çmimeve për njësi: **1 750** (një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).

Titullari i Autoritetit Kontraktor